




**Republika e Kosovës
Komuna e Klinës**

MUNICIPALITY OF KLINA - OPŠTINA KLINA



2014 - 2016

PLANI I VEPRIMIT

PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOMUNËN E KLINËS

ACTION PLAN

FOR INTEGRATION OF THE ROMA, ASHKALI AND EGYPTIAN COMMUNITIES IN KLINA MUNICIPALITY

AKCIONI PLAN

ZA INTEGRACIJU ZAJEDNICE ROMA, AŠKALIJA I EGIPČANA U OPŠTINI KLINA

Përkrahur nga: Office for Democratic Institutions and Human Rights/ODIHR
Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

Zbatuar nga: Akademia për Trajnime dhe Asistencë Teknike

Udhëheqës projekti: Bari Zenelaj

Konsulentë: Arben Shala
Erkan vardari



**Republika e Kosovës
Komuna e Klinës**

**Plani i veprimit i Komunës së Klinës
për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian
2014-2016**

Klinë, qershor 2013

Lista e shkurtesave

AKP	Agjencioni Kosovar i Pronave
ATTA	Akademia për Trajnime dhe Asistencë Teknike
CRP/K	Civil Rights Program in Kosovo
DA	Drejtoria e administratës
DB	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
DFEZh	Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
DK	Drejtoria e Kulturës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
DNj	Drejtat e Njeriut
DShMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
DShPE	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente
DUMM	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
GTPPV	Grupi Teknik i Punës për Planin e Veprimit
KK	Kuvendi Komunal
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OJQ	Organizata jo qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PK	Policia e Kosovës
QAP	Qendra e Aftësimi Profesional
QKMF	Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
UNHCR	United Nations High Commissioner for Refugees
ZKI	Zyra Komunale për Informim
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim



Të nderuar bashkëqytetarë,

Përmes këtij dokumenti strategjik, të quajtur “Plani i veprimit për integrimin e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptianë në komunën e Klinës 2013 - 2016”, konfirmohet vullneti ynë politik dhe përkushtimi i komunës së Klinës për të ofruar një mjedis të sigurt dhe mundësi të barabarta për integrim të plotë të të gjithë qytetarëve të saj.

Veprimet e propozuara në këtë dokument strategjik të komunës së Klinës, shprehin qartë se çfarë duhet të ndërmerret me qëllim të përmbushjes së pritjeve të cilat burojnë nga ky dokument, me qëllim të krijimit të mirëqenies socio-ekonomike, përparimit shoqëror, mjedisit të sigurt për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian dhe integrimin e tyre të plotë dhe të qëndrueshëm në komunën e Klinës.

Hartimi dhe zbatimi i këtij plani të veprimit përfaqëson një hap tjetër të përparimit në punën dhe përkushtimin tonë me synim sigurimin e konsolidimit të një shoqërie me vlera të përparuara demokratike, e cila kujdeset për të gjithë qytetarët e saj pa dallim përkatësie etnike, fetare dhe politike.

Ky dokument strategjik i quajtur “Plani i veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Klinës 2013 - 2016” duhet të shihet si një instrument i fuqishëm në përmbushjen e qëllimeve thelbësore për realizimin e të drejtave të minoriteteve - siç janë integrimi i plotë i tyre në shoqëri , pjesëmarrja dhe gjithë përfshirja.

Me këtë rast dëshiroj që personalisht t’i inkurajoj institucionet e qeverisjes komunale të Klinës, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të komunitetit të biznesit, komunitetet etnike dhe komunitetin ndërkombëtar që t’i bashkëngjiten kësaj nisme të zbatimit të këtij plani dhe që të punojmë të gjithë së bashku ,duke e shprehur gatishmërinë time të rezervë, për të arritur që komunitetet pakicë të jenë të barabarta dhe të kenë një jetë të dinjitetshme brenda shoqërisë kosovare.

Plani i komunës për integrimin e komuniteteve RAE në komunën Klinës 2013-2016, duhet të jetë platformë e përbashkët e komunës së Klinës, sektorit të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë për një koordinim dhe harmonizim më të mirë të planeve dhe të burimeve tona të përbashkëta, në mënyrë që pritet të cilat burojnë nga ky dokument të jenë të arritshme.

Le të jetë kjo ftesa ime për të gjithë për t’u përfshirë në këtë ndërmarrje të rëndësishme për qytetarët tanë dhe të gjithë së bashku të vlerësohemi mbi baza të arritjeve tona.

Sinqerisht,

Sokol BASHOTA
Kryetar i Komunës së Klinës,

Hyrje

Dokumenti i Planit Komunal të Veprimit për komunën e Klinës ka për qëllim promovimin dhe respektimin e të drejtave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian si dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Dokumenti po ashtu siguron se legjislacioni është në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Synimi është që ky plan të promovojë në mënyrë aktive forcimin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit, në veçanti përmes dialogut dhe ndërtimit të institucioneve për zbatimin e të drejtave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu përmes këtij dokumenti synohet që të arrihet përkrahja dhe inkurajimi i punës së OJQ-ve që përfaqësojnë interesat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian dhe thellimi i bashkëpunimit me to, duke përfshirë të gjitha palët e interesit.

Përkushtimi i qeverisë së Republikës së Kosovës është shprehur përmes vizionit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare, ku deklarohet: *Republika e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, i lirë dhe demokratik ku do të vihen në jetë dhe respektohen standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si dhe të gjitha komunitetet do të mund të jetojnë pa frikë, të gëzojnë mundësi të barabarta dhe ta ndjekin vizionin e ndërtimit të së ardhmes së përbashkët.*

Komuna e Klinës, duke ndjekur politikën qeveritare konform përmirësimit të pozitës së etnive pakicë, gjithashtu ka shprehur përkushtimin e vet përmes deklarimit të vizionit: *Klina komunë e të gjithë qytetarëve, me respektim për diversitetin, e integruar në rrjedha evropiane, me mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë individëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.*

Në 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi shpalljen e pavarësisë duke e deklaruar Kosovën shtet të pavarur sovran si dhe duke paraqitur aspiratat për të ndërtuar një shtet të lirë e demokratik ku do të vihen në jetë e respektohen standardet më të larta ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut si dhe ku të gjitha komunitetet do të mund të jetojnë pa frikë, të gëzojnë mundësi të barabarta dhe ta ndjekin vizionin e ndërtimit të së ardhmes së përbashkët. Këto aspirata u reflektuan në Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila u miratua në 9 prill 2008 dhe hyri në fuqi në 15 qershor 2008.

Kjo kushtetutë ka integruar standardet më të larta të të drejtave të njeriut dhe i kushton një vëmendje të veçantë komuniteteve minoritare të Kosovës. Në kapitullin e tretë të Kushtetutës të dedikuar posaçërisht për të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre thuhet shprehimisht se krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ata gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë. Kapitujt e veçantë për të drejtat e minoriteteve të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dëshmojnë qartë për vullnetin e mirë të Republikës së Kosovës për të bërë të mundur që çdo qytetar i Kosovës pa dallim përkatësie, të jetojë i lirë dhe me dinjitet të plotë në territorin e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të përkushtimit për të garantuar një jetë sa më të mirë të të gjitha komuniteteve, Komuna e Klinës i kushton vëmendje të veçantë komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të cilët njihen zyrtarisht si komunitete të veçanta nga shteti i Republikës së Kosovës.

Plani i Veprimit për Integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian përbën një kontribut të rëndësishëm në përpjekjet e Komunës së Klinës për të ndërtuar një klimë tolerance, pajtimi dhe respekti të ndërsjellë mes komuniteteve të ndryshme.

Plani i Veprimit tregon që aktivitetet për të përmirësuar pozitën e etnive janë më tepër një pasuri se sa një detyrim kur kuptohet dhe aplikohet siç duhet. Është më tepër rezultat që është në përputhje me respektimin e vlerave për diversitet dhe tolerancë të dallimeve, të cilat dhe janë gur themel i shumicës së shoqërive demokratike.

Parimet

Komuna e Klinës e ndjek principin e integritit në baza të barabarta dhe përkushtohet që të garantojë respektimin e identitetit dhe përkatësisë kombëtare së pjesëtarëve këtyre tri komuniteteve duke luftuar çdo formë diskriminimi.

Komuna e Klinës, duke dashur që t'i jetësojë sa më shpejtë parimet dhe zotimet e paraqitura në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, angazhohet që të përdorë masa afirmative për ta përmirësuar me shpejtësi gjendjen e këtyre tri komuniteteve.

Komuna e Klinës, në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do të ndjekë në mënyrë strikte politikën e mundësive të barabarta, të përfshirjes sociale dhe antidiskriminimit.

Komuna e Klinës do të ketë një qasje përmes pjesëmarrjes së të gjitha palëve dhe do t'i përfshijë përfaqësuesit dhe shoqërinë civile të këtyre komuniteteve në zbatimin dhe monitorimin e Planit të Veprimit – njëlloj siç kanë qenë të përfshirë në procesin e hartimit të Strategjisë.

Procesi i hartimit të planit të veprimit, metodologjia

Hartimi i Planit të Veprimit për Integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Klinës ka filluar në pranverë të vitit 2013 me përkrahjen e ODIHR. Për këtë qëllim kryetari Sokol Bashota ka miratuar formimin e një grupi punues të gjerë dhe gjithëpërfshirës, i cili do të punojë në hartimin e planit të veprimit dhe të strategjisë komunale për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Klinës.

Plani i veprimit bazohet në Strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, dokument ky i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e aprovuar më datë 24 dhjetor 2008. Po ashtu udhërrëfyes për hartimin e planit të veprimit për komunën e Klinës ka shërbyer edhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE të cilin e ka aprovuar Qeveria e Republikës së Kosovës më 23 dhjetor 2009.

Në këto dokumente strategjike janë identifikuar 11 fusha të cilat duhen trajtuar nga institucionet qeveritare dhe lokale. Plani i veprimit për komunën e Klinës bazohet në këto 11 fusha, të cilat veç e veç janë trajtuar në detaje ku për secilën fushë janë identifikuar aktivitetet konkrete, treguesit, përgjegjësit për ndërmarrjen e atyre aktiviteteve, përkrahësit si dhe është reflektuar buxheti që është i paraparë nga përgjegjësit dhe përkrahësit, gjegjësisht nga organet lokale të qeverisjes, nga donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile.

Për hartimin e planit të veprimit për Komunën e Klinës është formuar një grup i punës, i përbërë nga përfaqësues të komuniteteve, nga organizatat e shoqërisë civile që i përkasin komuniteteve RAE, organizatave të tjera të shoqërisë civile vendore dhe ndërkombëtare, dhe organeve gjegjëse komunale. Përveç kësaj, janë konsultuar edhe përfaqësues të këtyre komuniteteve nga komunat

tjera si dhe organet komunale të komunave të tjera të Republikës së Kosovës për të marrë praktikat e mira ashtu që ky plan i veprimit të jetë i përdorshëm, i zbatueshëm dhe funksional.

Tryezat dhe punëtoritë gjatë fazës përgatitore me sukses i kanë shërbyer synimit për përfshirjen e një game të gjerë të përfaqësuesve komunalë dhe të komuniteteve. Kjo qasje ofron garanci që plani i veprimit do të zbatohet me sukses dhe do të ketë përkrahjen e shoqërisë së gjerë.

Metodologjia e përdorur është përmes planifikimit me pjesëmarrje, gjegjësisht përmes kornizës logjike dhe veglave të saj të planifikimit.

Një grup punues enkas i formuar për rishikimin e këtij dokumenti ka rishikuar rezultatet e të gjitha punëtorive paraprake duke i definuar në mënyrë eksplicite sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet që lidhen me integrimin e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në komunën e Klinës në fushat e dala nga strategjia qeveritare.

Planit i veprimit pritet t'i kontribuojë përmirësimit të pozitës që komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian i ka në komunën e Klinës, të respektohen si qytetarë të barabartë, t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore dhe të mos jenë subjekt i asnjë diskriminimi. Andaj plani i veprimit përcakton të drejtën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptiane për pjesëmarrje të barabartë në të gjitha strukturat e shoqërisë përfshirë këtu edhe politikën dhe ekonominë në Klinë.

Procesi i rishikimit të planit të veprimit ka ndjekur qasjen pjesëmarrëse dhe qasjen e bazuar në të drejta. Procesi i hartimit të planit të veprimit i ka ndjekur direktivat vijuese:

1. Strategjia është hartuar me një qasje pjesëmarrëse, duke përfshirë përfaqësues të organeve komunale relevante dhe të tri komuniteteve.
2. Komunitetet do të përfshihen në zbatimin dhe monitorimin e planit të veprimit.
3. Hartimi dhe zbatimi i planit të veprimit duhet të shihen në kontekst më të gjerë; iniciativat tjera të komunës dhe të institucioneve ndërkombëtare janë pika të referimit.
4. Planit i veprimit nuk synon të zëvendësojë por të plotësojë iniciativat e përgjithshme. Rrjedhimisht, plani i veprimit ndjek një qasje kryesore sa herë që kjo është e mundur, e plotësuar me veprime afirmative sa herë që kjo është e nevojshme.
5. Rekomandimet e Këshillit të Evropës, Planit i Veprimit i OSBE-së për Roma dhe Sinti si dhe rekomandimet e Kombeve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian janë direktiva të rëndësishme për hartimin dhe zbatimin e këtij plani të veprimit.
6. Zbatimi i sigurtë i strategjisë i bazuar në burimet e identifikuar financiare është kyç për përmirësimin e gjendjes së romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Përfshirja e zbatimit të Strategjisë si njërin ndër prioritetet e Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE), apo në Strategjinë e Planit Zhvillimor të Kosovës (SPZHK) dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) si dhe dispozitat relevante në buxhetin e Kosovës dhe të komunës së Klinës janë garanci për zbatimin e sigurtë dhe realist.
7. Komuna e Klinës do të themelojë një mekanizëm përgjegjës për zbatimin e planit të veprimit.

Organizimi institucional për zbatimin e Planit të Veprimit

Mbikëqyrja dhe koordinimi institucional i Planit të Veprimit të komunës së Klinës për zbatimin e planit të veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian do të ndodhë në tri nivele. Zbatimi i përditshëm do të kryhet nga drejtoritë gjegjëse, zyra për të drejtat e njeriut, organet tjera komunale në bashkëpunim me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë nga shoqëria civile.

Për ndjekjen e zbatimit të planit të veprimit, ekzaminimit të çështjeve në nivelin e politikave, të monitorimit të vazhdueshëm nga afër si dhe për të harmonizuar dhe koordinuar investimet e palëve komunës me ato të donatorëve, një grup pune teknik do të ngrihet dhe do të funksionojë si Grupi Teknik i Punës për Planin e Veprimit (GTPPV), i cili do të veprojë si sekretariat gjatë zbatimit të planit të veprimit.

Grupi Teknik i Punës do të mbulojë të gjitha fushat me synim zbatimin efikas të aktiviteteve të planit të veprimit dhe përmbushjen e objektivave të parapara në të:

Koordinimi. Koordinimi është një nga funksionet kryesore të GTPPV-së si rezultat i natyrës ndër sektoriale të planit të veprimit. GTPPV do të koordinojë punën ndërmjet organeve të ndryshme komunale. Gjithashtu, do të koordinojë punën midis institucioneve komunale dhe donatorëve, me theks të veçantë në nivelin teknik për të mos lejuar dyfishimet e programeve/projekteve. Njëkohësisht, do të sigurojë që burimet financuese dhe ato vendim-marrëse të njohin përmirësimet të dukshme, të cilat reflektohen në zbatimin e suksesshëm të planit të veprimit. Përmirësimi i koordinimit, i cili do të nxisë identifikimin e lidhjeve dhe burimeve plotësuese midis ekzekutivit të komunës dhe donatorëve, e po ashtu dhe të sektorëve komunalë, ndihmon në koordinimin e ndarjes dhe përdorimit me efikasitet të burimeve. Koordinimi do të mundësojë të drejtuarin e burimeve drejt fushave prioritare dhe ndërmarrjen e iniciativave të përbashkëta, rishikimeve dhe studimeve tematike, vlerësimeve të projekteve të veçanta dhe sektorëve në përgjithësi. Së fundi, GTPPV do të koordinojë dhe do të realizojë lidhjen midis organeve komunale, donatorëve, organizatave jo-qeveritare përmes: dorëzimit të raporteve periodike, komunikimit mbi çështje që kërkojnë ndërmarrjen e vendimeve politike pa vonesa gjatë përbashkës me probleme që kërkojnë zgjidhje të shpejta si dhe komunikimin e ndryshimeve të nevojshme në dokumentin e aprovuar të planit të veprimit.

Shkëmbimi i informacionit. GTPPV do të shërbejë si një platformë për ndarjen e informacionit midis vetë organeve komunale, donatorëve dhe organizatave joqeveritare. Do të sigurojë një dialog midis zbatimit të përditshëm të aktiviteteve të planit të veprimit dhe nivelit të monitorimit të zbatimit të politikave publike në përgjithësi. GTPPV do të shërbejë si një forum i mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit duke përdorur dhe gjetur forma krijuese si organizimi i takimeve tematike, paraqitja e projekteve dhe programeve të ndërmarra në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre si dhe prezantimeve të arritjeve dhe sukseseve të aktorëve të ndryshëm.

Monitorimi dhe Vlerësimi. GTPPV do të identifikojë, monitorojë dhe vlerësojë progresin kundrejt objektivave dhe treguesve të vendosur në planin e veprimit. Në këtë kuadër do të mbledhë dhe do të analizojë të dhëna të sjella nga palët e përfshira dhe projektet e mbajtura nga donatorët. Të dhënat dhe analizat e mbledhura do të bëhen publike çdo katër muaj. Gjithashtu, grupi teknik do të hartojë raporte gjashtë mujore progresi dhe raportin vjetor të cilët do të prezantohen dhe aprovohen nga kryesuesi i komunës. Raportet do të bëhen publike në faqen elektronike të komunës së Klinës përmes një linku të veçantë.

Informimi i publikut. Komuna e Klinës në vazhdim të përpjekjeve të saj për të rritur transparencën dhe llogaridhënien para taksapaguesve dhe partnerëve ndërkombëtarë, vlerëson se është e domosdoshme mbajtja e informuar e publikut mbi progresin gjatë zbatimit të planit të veprimit. Për të përmbushur këtë detyrë, komuna e Klinës do të sigurojë krijimin e një sub-faqeje në faqen elektronike të komunës, e cila do ta përmbajë dokumentin e planit të veprimit, strategjive referuese, si dhe të gjitha raportet e progresit dhe vendimet përkatëse që do të merren nga komuna lidhur me zbatimin e planit të veprimit. Hapësirë e nevojshme do t'u jepet informacioneve mbi projektet dhe programet e ndërmarrë nga komuna, donatorët dhe organizatat jo-qeveritare të cilat kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të planit të veprimit. Vend të veçantë do të zënë dhe raportet e vlerësimit periodik, studimet dhe hulumtimet që do të ndërmerren në kuadrin e planit të veprimit, kalendari i ngjarjeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.


Falënderimet

Hartimi i këtij Plani të Veprimit ishte përpjekje e përbashkët e institucioneve të ndryshme të Komunës së Klinës, përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile që vijnë nga komunitetet RAE dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile, përfaqësuesve të tri komuniteteve dhe organizatës ndërkombëtare ODIHR, të cilat së bashku kanë qenë të përfshirë në procesin e hartimit të këtij Plani të Veprimit.

Për këtë arsye Komuna e Klinës shpreh mirënjohjen e thellë ndaj palëve të përfshira në procesin e hartimit të Planit të Veprimit, në veçanti ndaj ODIHR për bashkëpunimin e ngushtë dhe ndihmën shumë cilësore të ofruar, të cilët dhanë kontribut të çmueshëm dhe mundësuan edhe realizimin e hartimit të këtij dokumenti.

Posaçërisht i falënderojmë përfaqësuesit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian që morën pjesë në grupet punuese për përpilimin e Planit të Veprimit, të cilët pa ekspertizën dhe përkushtimin e tyre hartimi i dokumentit do të kishte qenë i pamundur.

Struktura organizative e mekanizmit koordinues, monitorues dhe zbatues të planit komunal për integrimin e komuniteteve rom, shkali dhe egjiptian në Komunën e Klinës



Trupi këshillues: OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare si dhe shoqëria civile

Përgjegjësitë

Koordinatori: Koordinimi, bashkërendimi, monitorimi dhe raportimi mbi implementimin e aktiviteteve të PV për komunitete dhe kthim si dhe kryeson takimet me grupet punuese.

Sekretariati (Grupi Teknik i Punës për Planin e Veprimit): Grumbullon materialet e GP, sistemon, analizon si dhe përcjellë vendimet eventuale të koordinatorit ndaj GP. Përgatit material të nevojshëm për Koordinatorin.

Grupi punues (Gp): Në këto GP janë përfaqësuesit e KK Klinës, mandatet e të cilëve janë të koordinojnë zbatimin e PV, të monitorojnë dhe raportojnë mbi të arriturat.

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët në Komunën e Klinës

Ashtu siç dihet në mbarë Evropën, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët kanë qenë subjekt diskriminimi shekuj me radhë. Ata edhe sot ballafaqohen me diskriminim dhe paragjykime racore dhe gjenden në rrethin e ngushtë të diskriminimit, varfërisë dhe përjashtimit duke ngelur ndër komunitetet më të nëpërkëmbura në Evropë. Të gjithë treguesit social dhe ekonomik dëshmojnë qartë për këtë fakt dhe nxjerrin në pah vështirësitë dhe kushtet jetësore të komuniteteve më të varfra dhe ngecjes në zhvillim të gjithëmbarshtëm.

As Kosova nuk bën përjashtim në këtë gjendje për këto komunitete dhe, sikundër në gjithë Evropën, fatkeqësisht romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët janë më të diskriminuarit dhe janë ndër komunitetet më të varfra dhe më të pafavorizuara, si dhe ndër komunitetet me më pak perspektivë për të ardhmen e tyre.

Shkatërrimet që la pas lufta në Kosovë dhe më pas procesi i stërzgatur i përcaktimit të statusit final të Kosovës ka përkeqësuar në përgjithësi gjendjen ekonomike dhe sociale të popullsisë kosovare dhe ka prekur në mënyrë të veçantë edhe segmentet më të marginalizuara të kësaj shoqërie, ku përfshihen edhe këto tre komunitete.

Në komunën e Klinës jetojnë rreth 2.500 banorë që i përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, në më se 288 shtëpi të shpërndara në 20 lokacione të komunës. Komuniteti ashkali është komuniteti më i madh në numër, ndërsa pasojnë komuniteti egjiptian dhe më pas ai rom.

Gjatë luftës së viteve 1998-1999 edhe nga këto komunitete kishte shumë të larguar nga Kosova. Pas vitit 1999, pjesëtarët e këtyre komuniteteve kryesisht janë kthyer me iniciativë individuale. Një pjesë është kthyer në mënyrë të organizuar nga kampi i refugjatëve në Konik të Podgoricës (Mali i Zi) si dhe nga shtetet e ndryshme të Evropës. Në përgjithësi komunitetet në Komunën e Klinës ose janë kthyer në formën individuale ose përmes projekteve e ndryshme si përfitues. Por ka pasur edhe raste të kthimit të organizuar si në fshatrat Budisalc dhe Rudicë, ku programin e kthimit e kanë zhvilluar dhe zbatuar Perspektiva Evropiane gjatë viteve 2005/2008.

Pas luftës ata më shumë kanë mbetur të tubuar në zonën lagja "Mahalla" në Klinë, Shtupel dhe Rudicë, ku jeton pjesa më e madhe e këtyre komuniteteve. Megjithatë në kohëve të fundit ka një rritje të të kthyerve në komunën e Klinës në kuotën rreth 10%, qoftë nga kampet e refugjatëve nga rajoni, qoftë nga shtetet evropiane.

Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian tradicionalisht kanë jetuar në gjendje të vështirë socio-ekonomike në komunën e Klinës. Ata janë të shpërndarë nëpër disa lokalitete të komunës, por shumica kryesisht janë të orientuar në disa fshatra: Lagja "Mahalla", Shtupel, Budisalc, Klinavc, Rudicë, Grabanicë, Krushevë e Madhe, Jagodë, etj. Në numër më të vogël (mendohet në një numër nga 3-10 familje), jetojnë edhe në fshatrat Videj, Dullov, Dollc, Resnik, Jashanicë, Stupë, Volljakë, Bokshiq, etj. Në gjitha këto lokalitete ata jetojnë në fqinjësi me popullatën shumicë shqiptare dhe pakicat tjera, me të cilat mund të thuhet se në vitet e pasluftës kanë jetuar në bashkë fqinjësi të mirë. Kur flitet për lokalitete ku jeton komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian nuk bëhet fjalë për lokalitete të pastra etnike, por për lokalitete me popullatë të përzier.

Pothuajse të gjitha fshatrat shumica e shtëpive të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve janë afër me njëra tjetrën, por në disa vende të tjera, të cilat janë më pak të banuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, shtëpitë janë të shpërndara anembanë fshatit dhe komunitetet nuk janë të organizuara në bazën etnike.

Përfaqësimi politik. Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Klinës i ka edhe përfaqësuesit e vet politikë si dhe lidhshpirtin e tyre politik. Ashkalinjtë si komunitet shumicë në komunën e Klinës udhëhiqen nga Lidhja e Egjiptianëve të Kosovës (LEK), ashkalinjtë nga Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës (PDAK) dhe Romët nga Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK). Komuniteti egjiptian është pjesë e asamblesë komunale dhe zëvendës kryesuesi i asamblesë vjen pikërisht nga LEK.

Përfaqësimin e këtyre komuniteteve e gjejmë edhe në mekanizmat tjerë komunalë si në Komitetin për Komunitete dhe Zyrën Komunale për Komunitete.

Organizatave e shoqërisë civile. Organizatat e shoqërisë civile të komuniteteve RAE në komunën e Klinës janë mjaft aktive karshi përfaqësimit të denjë të interesave dhe nevojave të komuniteteve të tyre në të gjitha segmentet e jetës. Në komunën e Klinës veprojnë disa OShC që funksionojnë në kuadër të shoqërisë civile si organizata joqeveritare dhe të cilat posedojnë kapacitete solide për t'u përballur me sfidat e qëndrueshmërisë në këtë sektor. Të gjitha këto merren kryesisht me aktivitete të ndryshme që përkrahin fushën e arsimit dhe edukimit të komuniteteve RAE, fushën e të drejtave të fëmijëve, merren me çështjet gjinore, kulturës përmes promovimit të folklorit, me çështjet e kthimit dhe të riintegritimit, aktivitete humanitare, dhe në fusha të tjera të ndjeshme për këto komunitete. Të gjitha organizatat e shoqërisë civile që vijnë nga këto komunitete, në një formë apo tjetër, bashkëpunojnë me organet komunale si dhe me ministritë gjegjëse, me OJQ-të e komuniteteve të tjera vendore dhe ndërkombëtare.

Integritimi i Komuniteteve RAE. Kuvendi Komunal i Klinës që nga ditët e para të qeverisjes ka ndërtuar një klimë të volitshme bashkëpunimi të ngushtë me të gjitha institucionet relevante dhe mekanizmat në Kosovë me qëllim për të përmirësuar kushtet e jetesës për të gjithë qytetarët e saj, pa dallime etnie, feje, race, përkatësie politike dhe sociale. Edhe pse komunitetet RAE mbesin një hap prapa rrjedhave të integritimit të përgjithshme në Kosovë, kjo nuk mund të thuhet për komunën e Klinës. Në të vërtetë komunitetet RAE janë të akomoduar mjaft mirë në të gjitha sferat e jetës komunale dhe trajtohen si qytetarë të barabartë me të gjitha komunitetet tjera.

Arsimimi. Fëmijët nga këto komunitete shkollohen në gjuhën mësimore shqipe. Intelektualët nga këto komunitete i kushtojnë rëndësi të madhe arsimimit dhe këtë fushë e konsiderojnë si prioritet i parë kundrejt fushave të tjera. Motoja e këtyre komuniteteve në çdo manifestim dhe takim është "Pa shkollim nuk ka përparim".

Në periudhën e pasluftës shumë fëmijë mbetën pa e vijuar mësimin e rregullt, kështu që përmes fushatave të organizuara nga ana e intelektualëve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe me përkrahjen e DKA-së dhe organizatave ndërkombëtare, është arritur që një numër i konsiderueshëm i fëmijëve t'i kthehen bankave të shkollës.

Mediat. Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian nuk ka asnjë media të veçantë elektronike apo të shkruar. Ashkalinjtë dhe egjiptianët, për dallim prej romëve, janë shqipfolës dhe janë gjendje t'i përcjellin rrjedhat e ngjarjeve në Klinë. Redaksia në gjuhën rome në RTK është medium i vetëm të cilin qytetarët e përkatësisë rome mund ta ndjekin në gjuhën amtare.

Infrastruktura. Lokacionet në të cilët kryesisht jetojnë banorët e komuniteteve RAE në vitet e pasluftës janë karakterizuar si vende ku këto komunitete kanë pasur qasje të vështirësuar në infrastrukturë. Komuna e Klinës, për të përfillur parimin e barazisë etnike, lidhur me infrastrukturën ka kryer disa projekte të ndryshme me përfitim të gjerë. Është vazhduar me projekte të ndryshme aq

sa ka lejuar buxheti i komunës në fushën e arsimit, kulturës, shëndetësisë etj. Organizatat ndërkombëtare gjithashtu u janë përgjigjur nevojave të këtyre komuniteteve dhe janë kryer shumë projekte të tjera në bashkë-financim me komunën, të cilat zhvillohen edhe sot e kësaj dite. Janë realizuar me dhjetëra projekte të infrastrukturës, përfshirë ndërtimin e rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimeve, shtruarjen e rrugëve etj.

ZKKK gjegjësisht zyrtari për komunitetet RAE ka në dispozicion projekte të ndryshme infrastrukturore si rrjedhojë e komunikimit me banorët dhe përfaqësuesit e lagjeve të ndryshme. Projektet e tilla priten të realizohen varësisht prej fondeve që janë në dispozicion nga komuna, donatorët dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare.

Gjendja sociale. Situata sociale e komuniteteve RAE nuk është e favorshme dhe është brengosëse si për shoqërinë ashtu edhe për vet komunën. Ekziston një numër i familjarëve që janë të përfshirë në skemën sociale me kriteret të plotësuar, por sipas ZKK-së gjithashtu ekziston një numër i konsiderueshëm që nuk i plotësojnë kriteret por që në realitet konsiderohen si raste të vështira sociale. Situatën e këtillë e përcjellë ZKK, e cila e bën edhe shpërndarjen e ndihmave që vijnë nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe vendore në formë të mallrave si ushqimet, veshmbathjet etj. Për të zbutur gjendjen e vështirë sociale të këtyre komuniteteve, ZKK për këtë kategori sociale çdo vjet ndan nga buxheti i vet mjete për të furnizuar familjarët me lëndë për ngrohje.

Kthimi. Numri i familjeve të kthyer në komunën e Klinës nuk është i madh. Familjet e kthyer spontanisht vite më parë janë sfiduar me mungesë vendbanimi dhe kushteve të tjera. Komuna e Klinës ka ndarë prona komunale për ndërtim të objekteve banuese për të kthyerit dhe ka ofruar asistencën përmes kompletimit të dokumentacionit pronësor dhe lejeve për ndërtim, por sfidë mbeten mjetet financiare të nevojshme për ndërtimin e objekteve të banimit. Përveç kësaj në qytet janë kthyer edhe pesë familje të tjera, dy nga të cilat kanë pasur kthim të detyrueshëm. Për këto familje shtëpitë u ka ndërtuar UNDP dhe ASB.

Siguria. Në komunën e Klinës komunitetet RAE nuk ndjehen të kërcënuar apo të rrezikuar, andaj nuk ka familje që mbrohen nga organet e rendit. Komunitetet RAE në komunën e Klinës kanë lëvizje të lirë si dhe qasje në të gjitha institucionet lokale qeveritare dhe publike. Zbatimi i këtij dokumenti do të mobilizojë të gjitha strukturat relevante për t'i hapur rrugë këtyre komuniteteve për integrim të plotë, integrim ky i cili do t'i mundësojë këtyre komuniteteve gjithë përfshirjen, ruajtjen, promovimin, zhvillimin dhe përparimin e identitetit të tyre, traditës, dhe kulturës.

Konteksti politik dhe dokumentet e referimit

Strategjia duhet të shikohet në kontekst të dokumenteve tjera të rëndësishme politike në Republikën e Kosovës dhe në nivelin ndërkombëtar. Rekomandimet e strategjisë nuk synojnë të zëvendësojnë dokumentet e përgjithshme politike, por të ofrojnë rekomandime shtesë të dobishme dhe realiste për përmirësimin e gjendjes së tri komuniteteve në të gjithë sektorët relevantë.

Të gjitha strategjitë e tjera relevante apo dokumentet e përgjithshme politike të Qeverisë së Republikës së Kosovës si hartimi strategjisë 2009-2015 dhe doracakut për kthim të qëndrueshëm i Ministrisë për Kthim dhe Komunitete dhe që adresojnë gjendjen e këtyre tri komuniteteve, do të marrin parasysh Strategjinë për Integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë.

Për më tej, Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Kosovë (nr. 03/L-047, 13 mars 2008),

përfshijnë dispozita për zbatimin e masave afirmative që janë të domosdoshme për përmirësimin e gjendjes së romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve.

Deri në janar të vitit 2007 Bashkësia Evropiane ka prodhuar një numër të konsiderueshëm të rezolutave për komunitetin rom (shtatë nga Parlamenti Evropian¹ dhe tre nga Këshilli i Bashkësisë Evropiane²), raporte të shkëlqyera Evropiane³, dhe që nga viti 1984 Këshilli i Evropës në Strasburg ka prodhuar më tepër se 500 dokumente që lidhen me komunitetin rom, gjegjësisht në përfshirjen e tyre në fusha të ndryshme shoqërore.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka vendosur të drejtat e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve në qendër të vëmendjes, madje të drejtave të komuniteteve iu ka dedikuar posaçërisht kapitullin e tretë, ku zbërthehen me hollësi të drejtat e veçanta që gëzojnë qytetarët e Republikës së Kosovës që iu përkasin minoriteteve. Përveç kësaj, konventat ndërkombëtare që aplikohen edhe në Kosovë përfshijnë dispozita specifike kundër diskriminimit, dhe më të rëndësishmet prej tyre janë (a) Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut; (b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollat e saj; (c) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollat e saj; (d) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (e) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas; (f) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, dhe (h) Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Përveç këtyre, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore është e aplikueshme në Kosovë.

Këto standarde ndërkombëtare ofrojnë një kornizë të gjerë mbrojtëse për individët dhe komunitetet kundër diskriminimit.

Për më tepër, në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, Qeveria e Kosovës më 30 korrik të vitit 2004 miratoi Ligjin kundër Diskriminimit (Ligji nr. 2004/3) dhe Udhëzimin Administrativ për implementimin e tij Nr-4/2006. Ky Ligj ka për qëllim të pengojë dhe luftojë diskriminimin, të promovojë barazinë efikase dhe të zbatoj principet e trajtimit të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës (Neni 1). Ligji bazohet mbi tri principe kryesore: trajtimi i barabartë, përfaqësimi i drejtë, mirëkuptimi dhe toleranca ndëretnike.

¹ Rezoluta e Parlamentit Evropian për Situatën e Romëve në Komunitet (1984); Rezoluta e Parlamentit Evropian Mbi Edukimin e Fëmijëve prindërit e të cilëve nuk kanë vendbanim të përhershëm (1984); Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi Analfabetizmin dhe Edukimin e fëmijëve prindërit e të cilëve nuk kanë vendbanim të përhershëm (1989); Rezoluta e Parlamentit Evropian për Romët në Komunitet (1994); Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi Diskriminimin kundër Romëve dhe Sintëve (1995); Rezoluta e Situatës së Romëve dhe Sintëve në Bashkësinë Evropiane (2005); Rezoluta mbi Situatën e femrave Rome dhe Sinti në Bashkësinë Evropiane (2006).

² Rezoluta Nr. 89/C 153/02 e Këshillit të Bashkësisë Evropiane mbi dispozitat shkollore për fëmijët romë dhe ata udhëtarë (1989); Rezoluta e Këshillit dhe Ministrave të Edukimit përbrenda Këshillit për dispozitat shkollore për fëmijët udhëtarë të zënë me punë (1989); Rezoluta e Këshillit dhe përfaqësuesve të vendeve anëtare; Takimeve Qeveritare përbrenda Këshillit mbi Gatishmërinë e Sistemeve të Edukimit për trajtimin e problemeve të Racizmit dhe Ksenofobisë (1995)

³ Përkrahja e BE-së për Komunitetin Rom (2002), Situata e romëve në një Evropë të zmadhuar (2004) Punësimi dhe Çështjet Shoqërore; Rishikimi i asistencës PHARE të Bashkësisë Evropiane për minoritetet romë (2004) "Mbrojtja e minoriteteve në BE" nga Rrjeti i BE-së i ekspertëve të pavarur për të drejtat fundamentale (2004); Barazia dhe jo-diskriminimi – Raporti vjetor (kaptina e veçantë për "Përmirësimin e situatës së romëve në BE); Punësimi dhe Çështjet Shoqërore - Opinonet Kyçe 2005: Qasja në Drejtësi

Përshkrimi i fushave të planit lokal të veprimit

1. Anti-diskriminimi

Kjo fushë prek çështjen e diskriminimit dhe ka për synim të identifikojë mekanizmat legjislativë dhe ekzekutivë për luftimin e saj. Qeveria komunale është e përkushtuar që me të gjitha mënyrat dhe në përputhje me ligjet në fuqi të punojë në parandalimin e kësaj dukurie. Kjo çështje do të shtjellojë në detaje dhe do të merr parasysh mendimet dhe vërejtjet e parashtruara nga qytetarët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Thëksim i veçantë do t'i jepet harmonizimit të veprimeve të kësaj fushe me objektivat gjegjëse të Strategjisë Nacionale për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Çështja e anti-diskriminimit ka qenë pjesë e shumë debateve publike në të cilat kanë marr pjesë aktive zyrtarët gjegjës komunalë, të cilët kanë dhënë mendimin tyre se cilat aktivitete janë të realizueshme për parandalimin e saj me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave elementare të të gjithë qytetareve me fokus të veçantë në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian. Andaj nëpërmjet realizimit të objektivave të planifikuara theksohet përkushtimi i qeverisë lokale për parandalimin e diskriminimit në të gjitha strukturat komunale.

2. Arsimi

Komuna e Klinës, gjegjësisht Drejtoria e Arsimit dhe e Shkencës, është tejet e interesuar dhe e përkushtuar që asnjë fëmijë të mos mbetet jashtë procesit mësimor. Në kuadër të këtij plani të veprimit qeveria lokale është e interesuar të trajtojë katër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian: vijueshmëria e parregullt e nxënësve të këtyre komuniteteve, cilësia e të nxënësve, siguria dhe edukimi joformal. Për të përmirësuar vijueshmërinë DKA është përkushtuar që të ndërmerret një sërë aktiviteteve si organizimi i fushatave ndërgjegjësuese, organizimi i orëve plotësuese, ofrimi i pakove me materiale didaktike, angazhimi i mësimeve të mentorëve, të bëjë rregullimine këndeve të lojërave ashtu që shkollat të jenë mjedise tërheqëse për fëmijë, organizojë kurse të ndryshme për semimaturën dhe maturën shtetërore, të rregullojë terrene sportive, të japë bursa për këto komunitete, të sigurojë mentorë dhe tutorë, dhe shumë e shumë aktivitete të tjera me qëllim që nxënësve të këtyre komuniteteve t'u ofrojë një qasje të barabartë në arsim përmes ndërmarrjes së veprimeve afirmative.

3. Punësimi dhe Fuqizimi Ekonomik

Nëpërmjet kësaj fushe Kuvendi Komunal dëshiron që të trajtojë çështjet me rëndësi për punësimin e përfaqësuesve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Sikurse edhe komunitetet e tjera edhe komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian është i ndikuar nga një shkallë e lartë e papunësisë. Shumë nga përfaqësuesit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian janë të varur nga asistencë sociale dhe jetojnë në kushte të vështira jetësore. Ata të cilët punojnë, zakonisht janë të punësuar në bujqësi, dyqane zejtare dhe merren me aktivitete vet-punësimi (bartës të mallrave, punë krah, etj). Disa nga anëtarët e këtyre komuniteteve janë të punësuar në sektorin publik dhe atë zakonisht në poste të ulëta për arsye të mungesës së përgatitjes profesionale. Sfidat më të madhe për komunitetet në procesin e kërkimit të punësimit qëndron në mungesën e resurseve të arsimuara të cilat në të kaluarën kanë qenë të ndikuar nga shkalla e lartë e braktisjes së shkollimit.

Njëkohësisht Kuvendi Komunal dëshiron të gjejë mënyra që gjatë punësimit të ardhshëm brenda strukturave t'i jepet përparësi aplikuesve të cilët vijnë nga këto komunitete. Kjo për arsye se sipas

ligjeve në fuqi strukturat komunale duhet të reflektojnë strukturën etnike të popullsisë që jetojnë brenda komunave.

4. Shëndeti dhe Çështjet Sociale

Fusha përfshin kontekstin shëndetësor dhe social dhe njëkohësisht ndërgjegjëson për pozitën me të cilën ballafaqohen përfaqësuesit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Duhet të ceket se Kuvendi Komunal i kushton një rëndësi shumë të madhe shëndetit dhe çështjeve sociale për arsye se kjo është njëra ndër mënyrat më të qëndrueshme për reduktimin e varfërisë në nivel komunal. Shëndeti i dobët i qytetarëve ka ndikimin e saj edhe në rrjedhat e tjera shoqërore për arsye që ndikon tek familjet që për shkaqe të tilla shesin të mirat e tyre dhe orientohen vetëm në blerjen e gjërave elementare sikurse që janë ushqimi dhe veshmbathja dhe njëkohësisht pamundëson zhvillimin e sferave të tjera ekonomike. Andaj edhe të gjitha ligjet në fuqi udhëzojnë për një qasje më të ndjeshme të strukturave komunale ndaj këtyre komuniteteve dhe atë në vartësi nga karakteristikat dhe kontekstit lokal.

Kuvendi Komunal dëshiron që në bashkëpunim me organizatat tjera të cilat merren me çështjet shëndetësore dhe sociale të kenë veprime koherente dhe të janë në përputhje me veprimet në nivel lokal dhe qendror. Një veprim më i suksesshëm në këtë fushë kërkon një angazhim afatgjatë të të gjitha strukturave qeveritare dhe joqeveritare dhe njëkohësisht të shikohen mundësitë që përveç financimeve nga buxheti i konsoliduar të shikohen fonde shtesë nëpërmjet organizatave donatore që janë prezente në Kosovë.

5. Strehimi dhe Vendbanimet Joformale

Qëllim i kësaj fushe janë përcaktimi i rregullave dhe i procedurave administrative për mënyrat e shpërndarjes, administrimit dhe planifikimit të programeve sociale për strehim dhe të vendbanimeve joformale, me qëllim të krijimit të kushteve të mirëfillta për jetesë për përfaqësuesit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Njëkohësisht nëpërmjet kësaj fushe Kuvendi Komunal brenda përgjegjësisë së saj dëshiron që të lehtësojë integrimin e këtyre komuniteteve në nivelin komunal.

6. Kthimi dhe Riintegrimi

Që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Kosovës është theksuar përkushtimi i institucioneve Kosovare në nivelin qendror dhe lokal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicave etnike që jetojnë në Kosovë. Të gjitha nivelet politike dhe ekzekutive kanë marrë mbi vete obligimin që të punojnë për kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur nga vendet perëndimore dhe ballkanike.

Sipas këtij dokumenti strategjik, Kuvendi Komunal i Klinës ka për obligim që të ndihmojë, organizojë dhe koordinojë procesin e kthimit të qëndrueshëm në nivelin komunal. Njëkohësisht Komuna e Klinës është e përkushtuar që të punojë në krijimin e kushteve të mirëfillta për jetesë për të gjithë personat e kthyer në mënyrë vullnetare apo të detyruar.

Në takimet e ndryshme që zyrtarët komunalë kishin me përfaqësuesit e të kthyerve është identifikuar nevoja për integrimin kulturor të të kthyerve (të shumtën e rasteve të rinjtë) pasi që duke jetuar një kohë të gjatë në vendet perëndimore nuk e kanë përdorë gjuhën e tyre dhe e kanë të vështirë tashme që të integrohen në shoqëri. Për këtë qëllim edhe kërkohet që të bëhet një

koordinim i veprimeve të organizatave të shoqërisë civile dhe zyrtarëve komunalë me qëllim të organizimit të aktiviteteve për integrimin e tyre në shoqëri.

7. Regjistrimi dhe Dokumentacioni

